Lethë, më 29.03.2023

# PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 29.03.2023, në orën 13:00, në sallën e Qendrës Kulturore të Fëmijëve (QKF), mbi mbledhjen e radhës të muajit Mars 2023, të Këshillit Bashkiak Lethë, me prezencën e kryetarit të Bashkisë z. Pjerin Ndreu dhe zv/kryetarit z. Ermal Pacaj.

Mbledhja u hap nga kryetari i Këshillit Bashkiak z. Ndue Luli, i cili lexoi rendin e ditës si dhe projekt-vendimet shtesë.

Ndue Luli: Kush është dakord me rendin e ditës duke futur edhe 2 projektvendimet shtesë?

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.

Atëherë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, që është projekt vendim "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-28 shkurt 2023".

Nqs nuk ka diskutime, e kalojmë në votim.

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.

Kalojmë te pika 2 e rendit të ditës, që është projekt-vendim "Për miratimin e prioriteteve dhe projekteve për investime për vitin 2026 në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2024-2026".

Ka kush diçka në lidhje me projekt vendimin?

Agostin Marku: Dua të di nga specialistët, nga ana teknike më shumë, pse vetëm për vitin 2026 sepse atje e kemi 2024-2026, këtu na vjen vetëm 2026

Thjeshtë për këtë. Nuk kam asnjë vërejtje për prioritetet.

Esmal Pacaj: kjo është për 2024-2026, mund të jetë një lapsus

Ndue Luli: Kush është dakord me projekt vendimin?

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.

Kalojmë te pika 3 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për miratimin e tarifave të shpenzimeve sipas programeve buxhetore për PBA - në 2024-2026 (Faza e Parë) të Bashkisë Lezhë".

Meqë nuk ka diskutime e kalojmë në votim.

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë përveç z. Agostin Marku që nuk votoi.

Kalojmë te pika 4 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për miratimin e ndihmës financiare për z. N. L. nga fondi i emergjencës".

Agostin Marku: Me leje. Në kuadrin e transparencës, unë e kam thënë edhe njëherë në mbledhje të këshillit. Nuk është mirë të shkruhet me iniciale. Shkruhet emri dhe mbiemri i plotë. I ka ndodhur fatkeqësia, nuk ka ndonjë problem, nuk e fyejmë. Kur bashkia e ndihmon dhe u gjendet njerëzve është gjë pozitive. Do të thotë që bashkia është afër shtresave sociale.

Esmal Pacaj: Në projekt vendim është emri i plotë. Kjo është për arsye se mbledhja është live

Ndue Luli: Se për dijeni, secili nga ne, e ka materialin me emrin e plotë. Këtu ishte te njoftimi i mbledhjes së këshillit
Kush është dakord me projekt vendimin?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë, përveç z. Apostin Marku që nuk votoi.
Kalojmë te pika 5 e rendit të ditës që është projekt vendim " Për miratimin e planit - masave për parandalimin, menaxhimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota si dhe krijimin e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve për vitin 2023".
Meqë nuk ka diskutime, e kalojmë në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë, përveç z. Apostin Marku që nuk votoi.
Kemi pikën 6 të rendit të ditës që është "Raport për punën/veprimtarinë e këshillit të Bashkisë Lezhë për vitin 2022" që e ka secili nga ju, besoj e keni lexuar.
Kemi dhe pikën 7 " Informacion për këshillin Bashkiak për ndryshimet klimatike dhe situata mjedisore në Bashkinë Lezhë". Është një informacion që punonjësi që ka qenë i ngarkuar për përgatitjen, e ka dërguar dhe e kemi secili nga ne, por për arsye shëndetësore mungon sot.
Kalojmë te 2 pikat shtesë në rendin e ditës.
1- Projekt vendim "Për miratimin e listës së

pjesshme paraprake të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohet të transferohet në pronësi të Njësisë Administrative Blinisht, Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë".

Ermal Pacaj: Si ky p/vendim për Nj. A. Blinisht, ashtu dhe p/vendimi tjetër për Nj. A. Ungrej, janë 2 projekt vendime të njëpasnjëshme, pasi një punë voluminoze që po bën Drejtoria e Kadastrës për regjistrimin e pronave të Bashkisë Lezhë. Ne kemi një situatë jo të zakonshme me pronat në Bashkinë Lezhë. Pronat duhet të marrin paraprakisht miratimin e Këshillit që të shkojnë pastaj për VKM në Këshillin e Ministrave. Pra, po ndjekim hapat ligjore që këto prona të regjistrohen në Kadastër.

Agostin Markaj: Me lejë. Unë nuk kuptoj një gjë te këto 2 projekt vendime. Çfarë do të thotë paraprake? E dyta, një bashki e fortë shihet dhe nga pronat që ka, por ngjanjëherë pronat, kur nuk janë rentabël, kthehen në kosto të madhe për bashkinë. A ka bashkia ndonjë projekt ambicioz për mënyrën e administrimit dhe menaxhimit të këtyre pronave që vijnë herë pas here për vendim në Këshillin e Bashkisë, të cilat shkojnë e miratohen edhe në qeveri dhe i legjitimohen si prona të ligjshme Bashkisë, që të rriten dhe autoriteti dhe potenciali financiar i Bashkisë, por që këto prona gjenerojnë të ardhura?

Pjerin Ndreu: Pyetjes së dytë i përgjigjem unë, të parës Ermali. E fillojmë nga e dyta. Problemi i regjistrimit të pronave është goxha i zakonshëm sensitiv, për ka të bëjë me mbarëvajtjen e punës së Bashkisë. Në fakt ky proces duhet të ishte bërë me kohë. Fakti që nuk është bërë me kohë, nuk do të thotë që ne nuk do ta bëjmë. Ne jemi në proces të regjistrimit të pronave, të fondit pyjor. Në rastin konkret ne jemi duke identifikuar prona shtetërore sepse kemi dise lloj afertosh. Në disa raste ne jemi detyruar të kthejmë mbrapsht kompani të mëdha, për arsye sepse nuk kemi pasur të regjistruar pronën. Pra, hapi i parë është që këto prona të kalojnë në pronësi të bashkisë. sepse interesim ka. dhe bëhet fjalë për kapacitet bujtës. Kjo është mesë paraprake që ne mos t'i sorrellosim njerëzit për të bërë një investim, që për ta kuje punësom njerëz, taksat i paguan këtu nesër. Pra gjeneron të ardhura dhe çdo gjë do jetë transparente

Ermal Pacaj: Lista paraprake është sepse në fakt nuk është listë pronash që bashkia e ka. Ajo regjistrohet me VKM. Në momentin që kalon me VKM atëherë është listë, nuk është listë paraprake. Qeveria mund të ketë një plan tjetër për në bashkëpunim me bashkinë

të bëjë x gjë. Besoj jam shterues në këtë gjë.
Ndue Luli: A ke ndonjë mendim tjetër në lidhje me këtë projekt vendim?
Meqë nuk ke atëherë e kalojmë në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezent.
Kalojmë te projekt vendimi i dytë i datës që është "Për miratimin e listës së përshkrimeve paraprake të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohet të transferohet në pronësi të Njësisë Administrative Ungrej, Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë, për pasurinë sipas inventarit, me emërtim Ranishte, Fshati Gjobardhaj dhe Fshati Kolivoç, Nj. A. Ungrej".
Sqarimi u dha nga kryetari dhe zv/kryetari edhe për këtë projekt vendim.
E kalojmë në votim. Kush është dakord?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Atëherë kalojmë te pika "Të ndryshme".
Kush e do fjalën?
Rigels Nicaj: Kisha një sugjerim. Te faqja e webit të Bashkisë, kur hyj klikoj, te këshilli Bashkiak ndër vite nuk më del. Dhe para shumë kohësh, në lidhje me prioritetet e bashkisë, unë kam drejtuar një kërkesë për tre rrugë të fshatit Ishull Lezhë. Kam marrë deri diku përgjigje por kryesisht dua që të jetë prioritet. Dua që t'i shërbej komunitetit tim

Jemi të zgjedhur dhe prandaj i sjellim këtu problematikat për t'i diskutuar dhe ~~pse~~ jo për të marrë dhe vendime për to.

Pjerin Ndreu: kërkesat për rrugë janë të natyrshme sepse pa infrastrukturë nuk ka kuptim. Në Ishull janë bërë 3 rrugë. Nuk janë bërë ato që thotë Rigels.

Unë ju falënderoj për gjithë përkushtimin që keni treguar, por mos të harrojmë diçka. Njerëzve duhet t'u themi të vërtetën.

Një gjë që ne e kemi të certifikuar. – Jemi bashkia që jemi transparente 100 % me të gjitha të dhënat, janë publike. Çdo informacion vihet në dispozicion menjëherë për të gjithë, qytetarë, gazetarë. Duhet t'u tregoni edhe që e kemi gjetur bashkinë me 4,6 mld borxhe, Po mos ta kishim gjetur këtë borxh, do ishin bërë edhe ato 3 rrugët e tua. Nuk po hyj me ty për vendet e punës e për neftin. Kjo është politikë. Por janë fakte. Këto ditë del programi ynë, i shkruar, i studiuar, njësi për njësi, diçka pasi prioritet numër 1, rrugët rurale. Ne do shkojmë në zgjedhje, besoj, ose me zero borxhe, ose me një shumë të pa-llogaritshme dhe do dalim në mandatin tjetër me një tjetër performancë, do dalim me buxhetin e vitit 2024 me një tjetër qasje, me një pesë

që ne, me burimet e të ardhurave, që do jenë
absolutisht në Shtim, me një administrim akoma
më të fortë dhe më konkret, ne do bëjmë
shumë punë publike, po ky me përmend postaj,
projektet që kemi me përveçinë.
Nuk bëj rrugë elektorale dhe nuk shtoj organikën
me punësime elektorale. Rrugë janë vetëm ato
që janë me planifikim në buxhetin e vitit 2023
që janë miratuar këtu, nga ky këshill.
Unë e di që ke shumë nevojë, por gjërat kanë
radhë. Ju jeni pjesë e shqetësimit si pjesë e
komunitetit. Ne kemi dhënë shpjegime për lagjen
e Spitalit, për lagjen "Nënë Tereza", për Shënpjetrin.
Në qytet është investimi gjerman që më në fund do
të fillojë, që u ndalua për shkak të pandemisë.
Gjithë sistemi i ujërave të zeza e të bardha do të
vihet nën kontroll. Ujërat e zeza do kalojnë në
impiant. Aktualisht, nëse ke një reshje shiu,
Lezha mbushet me ujë, pavarësisht se kullimi
është më i shpejtë. Me këtë investim, Lezha
kurrë nuk do mbushet më me ujë. Janë dy
stacione pompash, që nga lagjja e Spitalit që
disiplinojnë të gjitha ujërat e shiut dhe nuk
ka shanse më që Lezha të përmbytet. Tjetri thotë
dhe rrugë, nuk dua t'ia di se ça do bësh ti.
Np.s do ishte problem elektoral, do shkojë te
rruga e Spitalit të bëjë rrugë, por ne nuk mund

të bëjmë shkaka të tilla me lekët e taksa-paguesve lezhjanë. As në lagjen "Nënë Tereza" nuk mund të bëhet asnjë metër rrugë. Ne nuk i kemi bërë. Pse? Sepse do shkojë ujësjellësi. E njëjta gjë edhe në Shëngjin. Është firmosur. Do fillojë. Edhe Gocaj-Kakarriq. Është po investim gjerman. Janë 16.1 milionë euro investim.

Do bëhet ujësjellësi njëherë, për atë për e kuptojmë politikën e zhvillimit, se si një radhë e zhvillimit, është krejt normale, njëherë bëhet ujësjellësi, pastaj bëhen rrugët, me sinjalistikë horizontale e vertikale në nivele bashkëkohore.

Ndue Luli: Faleminderit kryetar.

A ke dikush diçka tjetër?

Mepë nuk ke diskutime të tjera, atëherë mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

— Mbledhja u transmetua live në Facebook.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI